

Filmi shqiptar në Beograd

"Koha e Kometës" në Festivalin Ndërkombëtar "FEST"

Aktori kryesor dhe producenti Blerim Destani lidhur me pjesëmarrjen e filmit të tij në Beograd shprehet: "Arti nuk njih kufi! Ky është njëri ndër sloganet që është vërtetuar gjithmonë dhe vërtetohet edhe tani..."

Pas vlerësimit si "filmi më i mirë shqiptar" në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit, që u mbajt në Durrës, filmi "Koha e kometës" i regjisorit Fatmir Koci tani është përzgjedhur për pjesëmarrje në Festivalin ndërkombëtar të filmit - FEST në Beograd, ku do të konkurrojë me tetë filma të tjerë në kategorinë "Europa jashtë Europës". Në këtë kategori janë përzgjedhur tetë filmat më të suksesshëm që janë prodhuar nga shtetet që ende nuk janë pjesë e Unionit Evropian. "Koha e kometës" do të përfaqësojë Shqipërinë. Anëtarët e jurisë ndërkombëtare janë: Jeshim Ustaoglu, regjisor nga Turqia, Mihael Demopolus, ish drejtori i festivalit të Selanikut dhe Dubravka Lakić, kritike filmi e gazetës "Politika".

Ky është edhe një tregues për vlerat e "Koha e kometës" që vazhdon të shfaqet nëpër festivale dhe kinema ndërkombëtare.

Filmi ka përjetuar vlerësime të larta nga kritika ndërsa është mirëpritur në mënyrën më të shkëlqyer nga ana e publikut. Tregues më i mirë për këtë është fakti se filmi i theu të gjitha rekordet e shikueshmërisë së tetë viteve në Prishtinë me gjithsej 10 mijë shikues.

"Arti nuk njih kufi! Ky është njëri



ndër sloganet që është vërtetuar gjithmonë dhe vërtetohet edhe tani. Për mua një shembull i mirë për këtë moto është pjesëmarrja e filmit Gjermano-Shqiptar "Koha e Kometës" i cili është ftuar të përfaqësojë Shqipërinë në kategorinë "Europa jashtë Europës" në festivalin e filmit në Beograd, kategori e sponsoruar nga gazeta e përditshme serbe "Politika". Pjesëmarrjet e ndërsjella në manifestimet kulturore si në Prishtinë, Tiranë, Shkup, Beograd apo edhe Athinë, tregojnë për një vetëdijesim të madh në këtë drejtim. Edhe pse mbetet shumë për tu bërë, kultura, arti dhe sporti

gjithmonë kanë hapet hapet e parë të afrimit të popujve me probleme ndërmjet vete. Si duket këtë e kanë kuptuar edhe popujt e Ballkanit", shprehet i kënaqur aktori kryesor dhe producenti, Blerim Destani.

Ngjarjet e filmit zhvillohen në vitin 1914 në kohën kur fuqitë e mëdha angazhojnë një princ austriak Vid që të udhëheqë Shqipërinë. Këto vite të turbullta përshkruhen në librin e shkrimtarit të madh Ismail Kadare "Viti i Mbrapshtë", mbi të cilin është bazuar edhe skenari i filmit, një bashkëpunim me kompaninë LARA Enterprises. (E.K.)

Libra të rinj në diasporë

"Kur takohen flamujt" dhe lidhen miqësitë mes popujve

Më 27 janar 2009, Stokholm. Botuesi "Shota" në Gislaved të Suedisë i dhuron lexuesit shqiptar në fillim të këtij viti edhe një libër të shkrimtarit Hamit Gurguri. Libri, me titullin "Kur takohen flamujt", përmban 13 novela dhe në 206 faqet e tij vijëzohet me një kolorit të pasur reliefi i një miqësie mes dy popujve.

Libri më i ri i shkrimtarit Hamit Gurguri po ashtu e ngacmon kujtesën e mërgimtarëve shqiptarë në Suedi. Jo rrallë ishte bërë fjalë shumë për ngritjen e një monumenti dikund në Suedi si shenjë e falënderimit të shqiptarëve për mikpritjen suedeze. Kjo nuk u bë deri tash por në vend të kësaj, shkrimtari Hamit Gurguri e ngriti këtë përmendore duke sjellë para lexuesit librin "Kur takohen flamujt".



Ballina e librit

Jo rrallë në ndeja shqiptare në Suedi është folur për njerëzit tanë që erdhën në Suedi para shumë viteve para se të vinte gjenerata e viteve 1990. Në gojë ziheshin emra të paktë të shqiptarëve që ishin ngulitur në këto troje skandinave para viteve 1960. Megjithatë ata këtu flitej për ndonjë person emri i të cilit ose ishte harruar, ose nuk thuhej me saktësi, ose se kishte ndërruar emër e mbiemër, por që ishte shqiptar dhe se kishte qenë ndër shqiptarët e parë në Suedi.

Kjo për shkrimtarin Hamit Gurguri nuk luan ndonjë rol aq të rëndësishëm. Për të ka rëndësi roli i atij që u vendos këtu, për kohë të shkurtër ose për jetë të jetëve, që luajti në dukjen e tij si shqiptar. Dhe, të jesh shqiptar në mërgim, për Hamit Gurgurin do të thotë të mos harrosh vendin ku "gjaku e loti ishin ushqim ditor" dhe vendi i tyre i prejardhjes ishte një vend "ku u vritej gjuha, kënga dhe gëzimi shqip".

Libri çilet me novelën mjaft simbolike, rreth ngjarjeve nga viti 1909. "Petriti i Konicës në Suedi", ringjall edhe njëherë diskutimin rreth Faik Konicës, nëse ai kishte qëndruar një kohë në Suedi apo jo.

Disa thonë se ai kishte qëndruar në Suedi e disa thonë jo, por kjo për këtë rast edhe s'ka aq rëndësi. Unë mendoj se e rëndësishmja është që Hamit Gurguri hap përmbledhjen e novelave me një personalitet i cili flamurin e luftës e ngre mu në mes të Evropës...

Libri përmban 13 novela. Secila me personazhe e ngjarje të caktuara nga qindvjetshi i kaluar. Secila periudhë e ardhjes dhe takimit të shqiptarëve me Suedinë dhe suedezët përmban vullën e kohës së vet që kurorëzohet me miqësi të reja. Kurora e kësaj miqësie vie pikrisht në novelën e fundit, e cila sipas mendimit tim shndërrohet në një leksion të artit të miqësisë.

Shkrimtari Hamit Gurguri, si edhe në romanet e tij të mëparshëm, përdor një gjuhë të lehtë por të pasur, të ruajtur me xhelozji nga vendlindja e tij. Edhe kësaj here ai arrin të krijojë tensione shpirtërore që ti si lexues kërkoni t'i heqësh menjëherë, por shkrimtari Hamit Gurguri si mjeshtër dhe njohës i mirë i tregimtarisë popullore, di të krijojë të papritura dhe nuk të dërgon në cakun e dëshiruar. Çudia është se ti prap do të mbetesh i kënaqur. ("Jehona", Suedi)

Filmi "Taken" shfaqet në kinematë amerikane

Film francez me "pikë të dobët" migracionin shqiptar


Filmi francez "Taken" në të cilin protagonistë negativë janë edhe shqiptarët, që nga pardje filloj të shfaqet në kinematë amerikane. Gazetat amerikane, kombëtare dhe lokale, i kushtuan mjaft hapësirë këtij filmi dhe shumë prej tyre nuk i dhanë kritika aq të mira

Një film ku e mira dhe e keqja janë të ndara me pe, ku heroi amerikan supernjeri i lufton kriminelët zakonisht të stereotipizuar (shqiptarët, arabët etj) duket se nuk e ka gjetur kohën e mirë për debutim në Amerikën e rilindur të Obamës.

Ja disa fragmente na këto kritika: "Qëndrimi ndaj popullatës shqiptare të qytetit (Parisit) gjithashtu nuk është ledhatuese. Imigracioni është një pikë e dobët për francezët, dhe shqiptarët janë portretuar si një epidemi që po tenton të shkatëroj çdo gjë që është e Mirë dhe e Mrekullueshme. Natyrisht, disa figura qeveritare franceze të korruptuara janë futur në këtë përzierje që të mos duket se ata (prodhuesit e filmit) janë shumë racistë." Karen Dahlstrom, www.bigpicturebig-sound.com

"Së pari, çfarë nëne do të lejonte vajzën e saj 17 vjeçe të bëjë diç të tillë? Dhe së dyti, sa 17 vjeçe adhurim bendin U2? Beyonce, po. Bono jo. Oh, harrova, ky është Luc Besson (skenaristi), njeriu që s'ka koncept për realitetin, dhe asgjë tjetër pos urrejtjes për femra. Marri! Për shkak se është aq i marrëzishëm, ju nuk mund të ndaleni së qeshuri, që në mënyrë të çuditshme e bën filmin të këndshëm. Sidoqoftë, filmin e pashë falas. Nëse paguani \$10 dyshoj se do të jeni në humor të ngjashëm." Al Alexander, www.norwichbulletin.com

"Filmi 'Taken' ka një temë rrëmbimi që pa qëllim është qesharak. Ky film i regjisorit Pierre Morel është energjetic dhe i dhunshëm dhe nuk mund t'i ikë faktit të jetë rastësisht qesharak." Keneth Tura-



Skenë nga filmi, ku Neeson torturon "kriminelin" shqiptar

n, www.npr.org

"Për shkak të një teme që mund ta rrezikoj industrinë e turizmit të Francës, sa shkel në Qytetin e Dritës ajo kidnapohet nga një bandë e pamëshirshme e shqiptarëve të cilët tregtojnë me skllave të bardha. Dhe do të besoni se i vetmi njeri që ka njohuri dhe aftësi që së paku të ketë një gjasë që ta sjellë prapa gjallë është babai i saj? Kushdo që të jetë, banda e pakëndshme shqiptare apo horda virgjin-prishëse arabe (disa stereotipe thjeshtë refuzojnë të vdesin), Mills ka një aftësi të qëndrueshme që të keqes t'ia tregojë vendin." Keneth Turan, http://www.calendarlive.com

"Jepja 'Taken'-it këtë: Nuk humbë kohë dhe të pretendoj që të jetë diç tjetër pos një film rreth një çuni të mirë që vret çuna të këqij. Në fakt, posa të nisë ylli Liam

Neeson që të vrasë çunat e këqij, duket sikurse ai bëhet i varur nga ajo. Ai në të vërtetë lufton nëpër katër nivele të çunave të këqij: hara-mave, shqiptarëve, francezëve të pasur dhe mostrave të Lindjes së Mesme. Nëse e urreni dike, gjasat janë se Liam-i do të vrasë diç të tillë." Tom Long, www.detnews.com

"Pasi që ai mbërrin në Francë, ndodhë një çudi në lidhje me një njeri që punësohet të përkthejë shqip. Çfarë prekje e mençur - hej, Bourne kurrë nuk punësoi ndonjë përkthyes. Për nja një minutë, filmi fillon me një logjikë të përafërt me botën reale. Por mandej Bryan-i fillon të përshkruhet me disa shqiptarë në gjuhën angleze, dhe ata ia kthejnë anglisht, dhe asnjërit prej tyre nuk u shkon në mend të thotë, "Ua!! Po a nuk jemi në Francë?" www.chron.com (Nga ukalbanians.org)

St. Gallen

Mbrëmje bamirësie me yjet e muzikës klasike

Më 6 shkurt 2009 në sallën më prestigjioze koncertale në Zvicër lindore, në "Tonhalle" mbahet mbrëmja gala bamirëse "The Best Of Opera" ku, nga artistë shqiptarë dhe të huaj të operës, baletit dhe instrumentistë do të prezantohen vepra të Verdi-t, Puccini-it, Bellini-it, Donizetti-it, Massenet-së, Bizet, Offenbach, Jakova, De Curtis, Mozart, Chopin, Sarasate. Këtë mbrëmje e organizojnë "Opéra Sans Frontières", Fondacioni "Bedri Dedja, gjithnjë për fëmijët" dhe Kiwanis

(distrikti Zvicër-Liechtenstein). Artistët, kryesisht shqiptarë, solistë të shtëpive të njohura operistike dhe instrumentistë po ashtu të shquar, që do të marrin pjesë në këtë mbrëmje bamirëse janë: Saimir Pirgu (tenor), Mariana Leka (Soprano) Enkelejda Shkosa (mezzo-soprano) Pekin Kirgiz (tenor), Frano Lufi (bas), Anila Kraja (violinë), Dania Bytyqi (piano) dhe Enkel Zhuti (solist baleti). Drejtimi artistik dhe koncert maester Edlira Dedja.

Më 07/08 shkurt 2009

FC Prishtina Bern Organizon Turnirin e 19 tradicional në Futboll të vogël

Të nderuar dashamirë të futbollit në Zvicër dhe jashtë Zvicrës, ju ftojme të merrni pjesë në turnirin tradicional, i 19-i me radhë, i organizuar nga klubi shqiptar më i vjetër në diasporë, FC Prishtina Bernë. Turniri mbahet më 7 (e shtunë) dhe me 8 (e diele) shkurt në sallën më të bukur në Bernë (Wankdorfhalle), afër Stadionit Stade de Suisse. Luhet me sistemin 5+1, ku një ekip duhet ti ketë min. 6 lojtarë e max. 10 lojtarë. Në këtë turnir pritet të marrin pjesë mbi 60 ekipe aktive dhe juniorë. Prandaj do të luhet të shtunën deri në orët e vona të natës (mesnatë), dhe të dielën nga ora 08:00 deri ora 19:00. Për dashamirët e muzikës kemi organizuar muzik (DJ) për të gjitha moshat në restorantin e sallës. Muzika fillon nga ora 19:00. Për arsye të konkurrencës ju lutemi të paraqiteni me kohë, afati i fundit është deri me 2 shkurt 2009. **Pagesa për Ekip kushton 150Fr. kurse për juniorët deri 14 vjeçarë vetëm 80Fr. Pagesën mund ta bëni nëpërmes: FC Prishtina Bern Postfach 213 3000 Bern KontoNr: 60-684317-8** Në këtë turnir do të ketë shpërblime të mira për 3 vendet e para. Kurse lojtari dhe portieri më i mirë i shpallur janë fitues të nga një bilete kthyes me autobus për në vendlindje. **Vendi 1 : 1200Fr. Vendi 2 : 700Fr. Vendi 3 : 400Fr.** Më tepër informacione mundeni të merrni mes telefonave: Islam Ramadani 079 625 43 20 Besim Fejza 079 291 09 52; Bujari Aziri 079 818 74 48 Skender Hallili 076 328 91 00. Po ashtu edhe në faqen e internetit www.fcprishtina.ch ose email info@fcprishtina.ch